

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr.21, datë 14.10.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 8451/4, DATË 5.1.2015, “PËR ÇAKTIMIN E ÇMIMIT DHE TARIFAVE TË BOTIMEVE TË QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE, SI DHE INSTITUCIONET QË PËRFITOJNË FALAS KOPJE TË BOTUARA TË FLETORES ZYRTARE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, dhe të nenit 16, pika 4, të ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 8451/4, datë 5.1.2015, “Për caktimin e çmimit dhe tarifave të botimeve të Qendrës së Botimeve Zyrtare, si dhe institucionet që përfitojnë falas kopje të botuara të Fletores Zyrtare”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çmimi i shitjes së çdo botimi, përfshirë dhe Fletoren Zyrtare, llogaritet si prodhim i çmimit për një faqe me numrin e faqeve të botimit. Çmimi për faqe është 4 (katër) lekë.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Për botimet me lidhje speciale, çmimi total i botimit është i barabartë me çmimin e prodhimit (4 lekë për numër faqesh) plus 250 lekë.”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Botimet, përfshirë edhe Fletoren Zyrtare, mund të shiten drejtpërdrejt nga Qendra e Botimeve Zyrtare me çmimin e vendosur në kapak. Pagesa kryhet në llogaritë e thesarit në sistemin bankar për llogari të Qendrës së Botimeve Zyrtare.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj